



Planuar / Dorezuar Prijemjen / Prodato Received / Delivered	19-08-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSKIL	4832/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.669/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në bazë të Aktgjykimit A.nr.2236/2021 të datës 13.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.669/2021 të datës 19.07.2021 të parashtruar nga ankuesja nga Skenderaj, kundër organit të punësimit Komuna e Skenderajt, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.669/2021 e datës 19.07.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Skenderajt, më datë 19.07.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 794/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për harmonizim e titullit të vendit të punës dhe koeficientit të pagës në harmoni me përshkrimin e detyrave të punës me koleget në kuadër të institucionit punëdhënës dhe institucioneve tjera, duke shtuar së kryen punët dhe detyrat e punës që korrespondojnë më punët dhe detyrat e Zyrtarit të Lartë të Prokurimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.07.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Skenderajt, ndërsa kjo e fundit më datë 09.08.2021 ka përcjell provat lidhur me çështjen ankimore.

Këshilli në mungesë të kuorumit për vendosje përmes Njoftimit me numër protokolli 4456 të datës 01.09.2021 ka njoftuar ankuesen lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtën mbi të drejtën e inicimit të procedurës së mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative më datë 16.05.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.2236/2021 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e datës 19.07.2021 të parashtruar nga paditësja tani ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:

Ankesën me numër protokolli 3794/2021 të datës 19.07.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailat/kërkesat e ankueses të datës 29.06.2018; Kërkesën e datës 29.06.2018 të ankueses për Drejtorinë e Administratës; Përgjigjen e datës 02.07.2018 të Drejtorit të Administratës për ankuesen; E-mailin e datës 08.03.2021 nga ankuesja për E-mailin e datës 24.04.2021 nga ankuesen; Kërkesën e datës 12.04.2021 nga ankuesja për Zyrën e Personelit të Komunës së Skenderajt; E-mailin e datës 14.06.2021 dhe 15.06.2021 nga ankuesen; E-mailin e datës 14.06.2021 nga ankuesja për Përgjigjen e datës 17.06.2021 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për ankuesen; Listën e trajnuesve të Certifikuar nga ILO 07-11 maj 2013; Kontratë mbi vepër Nr.154/17; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë i datës 20.12.2012, 03.01.2019, 07.12.2017, 27.12.2016; Certifikatën për pjesëmarrje 26-27 mars 2009; Certifikatën Themelore Profesionale për Prokurim Nr.175 dhe Nr. 184; Certifikatën e datës 04.04.2003; Kontratë për Shërbime të Veçanta e datës 18.10.2018; Kontratë e marrëdhënies së punës Nr. 02/112-318 e datës 19.04.2010, Nr.02/112-308 e datës 08.05.2009; Kontratë Pune me Nr. 112-624 e datës 30.04.2003; Certifikatën e datës 13.02.2019; Formulari PCF 2; Certifikata e Profesionalizmit në Prokurim e datës 15.03.2005; E-mailin e datës 03.03.2021 nga ankuesen; E-mailin e datës 02.03.2021 nga ankuesja për dhe Organogrami Final i Azhuruar Nr.112-604; E-mailin e datës 19.07.2021 nga ankuesja për ankesa.kpmschck@rks-gov.net; Akt Emërimit e datës 27.04.2012; Plani i Punës i datës 15.04.2005, 17.06.2005, 19.12.2011; Vendimin e datës 05.05.2009 nga Drejtori i Drejtorisë për Administratë dhe Personel; Rekomandim i datës 09.06.2009; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 09.12.2015 dhe 05.01.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 09.08.2021 dhe Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 27.07.2021; Njoftimin e datës 01.09.2021 për ankuesen; Aktgjykimin A.nr.2236/2021 të datës 13.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Emailin e datës 03.08.2022 nga ankuesja për Emailin e datës 03.08.2022 nga ankuesja për Listën e pagave për ankuesen dhe zyrtarët e tjerë të prokurimit; Akt Emërimit e datës 04.03.2021 për pozitën Zyrtar i Lartë i Prokurimit; Akt Emërimit e datës 27.04.2012 për Zyrtar Profesional i Prokurimit për nëpunësin Akt Emërimit e datës 27.04.2012 për Zyrtar Profesional i Prokurimit për nëpunësin Akt Emërimit e datës 25.02.2020 për pozitën Zyrtar e Prokurimit 2 për nëpunësin

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka analizuar Aktgjykimin A.nr.2236/2021 të datës 13.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative

si dhe bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së është e pabazuar ankesa e ankueses, *sepse*:

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesja Hafseje Zejnullahu, ka themeluar marrëdhënie pune në Komunën e Skenderajt me datë 01.12.2002 në pozitën e punës "Zyrtare për Prokurim", ku në mbështetje të legjislacionit të zbatueshëm ankueses në vazhdimësi i janë lëshuar kontratat e punës në afat një vjeçar për pozitën "Zyrtar për Prokurim". Me tej nga shkresat e lëndës del se me Vendimin e datës 08.05.2009 të Drejtorit për Administratë dhe Personel, ankueses në pozitën e Zyrtares të Prokurimit i është bërë nivelizimi i pagës, nga koeficienti gjashtë (6) në shtatë (7), ndërsa me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, institucioni punëdhënës ka bërë shndërrimin e kontratës së punës së ankueses në Akt emërim të përhershëm në pozitën "Zyrtare Profesionale e Prokurimit" me koeficient shtatë (7) të pagës.

Tutje, nga administrimi i provave të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur së ankuesja disa herë ka parashtruar kërkesë të punëdhënësi për harmonizim e titullit të vendit të punës dhe koeficientit të pagës në harmoni me përshkrimin e detyrave të punës, ndërsa më datë 08.03.2021 po me kërkesë të njëjta ankuesja i është drejtuar edhe Departamentit për Menaxhimin e Zyrtaresve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i cili në përgjigjen e datës 24.04.2021 ka njoftuar ankuesen së ngritja e koeficientit është kompetencë e vet institucionit. Pas kësaj përgjigje, ankuesja serish më datë 12.04.2021 i është drejtuar Zyrës së Personelit të Komunës së Skenderajt me kërkesë për harmonizim të koeficientit të pagës dhe titullit të vendit të punës barasvlerë me përshkrimin e detyrave të punës. Më datë 17.06.2021 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Skenderajt ka njoftuar ankuesen se më datë 08.05.2009 ka pranuar dhe nënshkruar vendimin si dhe akt emërimin e datës 27.04.2012 në pozitën "Zyrtar Profesionale i Prokurimit", kështu që koeficienti dhe përshkrimi i detyrave të punës mbeten në fuqi në bazë të Akt Emërimit të vitit 2012 deri sa të hyjë në fuqi ligji i ri i pagave.

Lidhur me shqyrtimin e themelësisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtares Publikë, përkatësisht nenit 19 ku theksohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, ndërlidhur me këtë neni 9 paragrafi 1 i po këtij Ligji përcakton se: *Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rezulton se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civilë të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës ju garantohet dhe duhet të realizojnë pagë të njëjtë për punë të njëjtë. Në kuptim të kësaj bazë ligjore dhe duke marrë parasysh shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankueses sipas Vendimit të datës 08.05.2009 të Drejtorit për Administratë dhe Personel në pozitën e Zyrtares të Prokurimit i është bërë nivelizimi i pagës nga koeficienti gjashtë (6) në shtatë (7), dhe së e njëjta realizon koeficientin e pagës sipas Aktit të emërimit më numër protokollit 112-324 të datës 27.04.2012, andaj, meqenëse Kolegji në provat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë akt tjetër administrativ të organit të punësimit përmes të cilës ankuesit i është njohur pozita e Zyrtares së Lartë të Prokurimit, rezulton së pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.*

Kolegji i Këshillit për vendosje meritorë të kësaj çështje juridike ka analizuar edhe nenin 7 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë me të cilin është përcaktuar se: *1. Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat...* si dhe Ligjin Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi përkatësisht nenin 4 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, andaj, në kuptim të dispozitave ligjore si më lartë dhe nw mbështetje të provave të lëndës, Kolegji konstatoj se në Zyrën e Prokurimit të Komunës së Skenderajt janë pesë zyrtarë të prokurimit të cilët sipas akteve të emërimit për pozitën e njëjtë të punës kanë koeficient 7 të pagës, kështu që bazuar në gjendjen e këtyre fakteve rrjedh se nuk kemi rrethana të trajtimit jo të barabartë dhe diskriminues të ankueses në raport me zyrtaret që ushtrojnë pozitë të njëjtë të punës dhe në institucionin e njëjtë punëdhënës.*

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur MbiKëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.669/2021

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Skenderajt;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajt dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

